

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "POLLUX" SH.P.K

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri, Themeluesit, Objekti

1.1 Sot, më datë 23/09/2024, bazuar në Aktin e Themelimit, krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar 'Pollux' Sh.P.K.

1.2 Themeluesit dhe aksionerët e shoqërisë 'Pollux' Sh.P.K janë si më poshtë:

- Z. Dritan Rama, shtetas shqiptar, i lindur më datë 30.01.1984, në Tiranë, identifikuar me nr. personal I40130204Q, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotërues i një (1) kuote që përfaqëson 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Z. Endri Hushi, shtetas shqiptar, i lindur më datë 20.04.1988, në Tirane, identifikuar me nr. personal I80420083B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotërues i një (1) kuote që përfaqëson 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Z. Lorenc Sala, shtetas shqiptar, i lindur më datë 17.08.1980, në Tiranë, identifikuar me nr. personal I00817094L, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotërues i një (1) kuote që përfaqëson 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 2

Objekti i Veprimtarisë

2.1 Shoqëria 'Pollux' Sh.P.K do të zhvillojë aktivitetin e saj me objekt: Kryerjen e aktiviteteve që mund të kryhen nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke përfshirë në mënyrë të veçantë: tregti, import-eksport, dhe shitje përmes platformave të ndryshme online.

2.2 Shoqëria mund të realizojë pjesëmarrje në shoqëri të tjera vendase ose të huaja, si dhe të kryejë veprime tregtare brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU II

Kapitali, Kuotat, Të drejtat e lidhura me to

Neni 3

Kapitali Themelues

3.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 15.000.000 Leke, të cilat do të

kontribuohen në tërësi nga aksionerët në mënyrë të barabartë si më poshtë:

- Z. Dritan Rama kontribuon 5.100.000 Leke, që përbën 34% të kapitalit.
- Z. Endri Hushi kontribuon 4.950.000 Leke, që përbën 33% të kapitalit.
- Z. Lorenc Sala kontribuon 4.950.000 Leke, që përbën 33% të kapitalit.

Neni 4

Kuotat, Të Drejtat e Lidhura me To

4.1 Secili nga aksionerët zotëron të drejtën e pjesëmarrjes në fitime në përputhje me kuotën e kapitalit të zotëruar.

4.2 Çdo kuotë mund të transferohet te të tretët vetëm pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve.

KREU III

Organet Drejtuese dhe Administrimi

Neni 5

Asambleja e Aksionerëve

5.1 Asambleja e Aksionerëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Ajo mbledhet të paktën një herë në vit për të shqyrtuar dhe miratuar bilancin vjetor, për të vendosur mbi shpërndarjen e fitimeve, dhe për të shqyrtuar çështje të tjera të rëndësishme.

Neni 6

Administratorët

6.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i vetëm, i emëruar nga Asambleja e Aksionerëve, me një mandat 4 vjeçar, duke filluar nga data 23.09.2024 deri ne daten 22.09.2028.

Administratori ka përgjegjësinë e menaxhimit të përditshëm të shoqërisë dhe përfaqësimit të saj përpara të tretëve.

6.2 Administratori i emëruar është:

- Z. Dritan Rama , i lindur më datë 30.01.1984, në Tiranë, identifikuar me nr. personal I40130204Q, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili do të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë që i delegohen sipas ligjit dhe këtij statuti.

KREU IV

Selia, Kohëzgjatja dhe Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 7

Selia e Shoqërisë

7.1 Selia e shoqërisë është në: Tiranë, Tirane Nr. Pasurie 5/664-N5/11, Zona Kadastrale 8270, Volumi 83, Faqe 81, Rr. Sulejman Delvina, Tiranë.

Neni 8

Kohëzgjatja

8.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar, përveç nëse aksionerët vendosin ndryshe.

Neni 9

Riorganizimi dhe Likuidimi

9.1 Shoqëria mund të riorganizohet, bashkohet, ndahet, ose të shpërbëhet sipas vendimit të Asamblesë së Aksionerëve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi.

KREU V

Dispozitat Përfundimtare

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

10.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë për interpretimin e këtij statuti apo për çështje që nuk janë rregulluar nga ky statut, do të zgjidhet sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, do të referohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

AKSIONERËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR 'POLLUX' SH.P.K


- Z. Dritan Rama

- Z. Endri Hushi


- Z. Lorenc Sala

Nënshkrimi i Aksionerëve:


- Z. Dritan Rama



- Z. Endri Hushi



- Z. Lorenc Sala



Data: 23/09/2024